

Kapitulli 6: Projekti Mekanik

6.1. HYRJE

6.2. VËSHTRIM EKONOMIKO SOCIAL DHE GJENDJA TEKNIKE E RRJETIT INXHINIERIK TË ZONËS NË STUDIM.

6.3. VËSHTRIM EKONOMIKO SOCIAL DHE GJENDJA TEKNIKE E RRJETIT INXHINIERIK TË ZONËS NË STUDIM.

6.3.1. Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit të furnizimit me uje

6.3.2. Rikonstruksioni i rrjetit të ujsjellesit te parashikuar

6.4. KRITERET E RIKONSTRUKSIONIT TË IMPIANTIT TË SHKARKIMIT TË UJRAVE TË ZEZA

6.4.1. Analiza e gjendjes ekzistuese e kalimeve horizontale të lidhjeve të brendshme nga godinat tek pusetat primare

6.4.2. Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit inxhinierik nëntokesor të shkarkimit të ujrave të zeza

6.4.3. Rikonstruksioni i rrrjetit të shkarkimeve të ujrave të zeza te parashikuar

6.5. KRITERET E RIKONSTRUKSIONIT TË IMPIANTIT TË SHKARKIMIT TË UJRAVE TË SHIUT

6.5.1. Analiza e gjendjes ekzistuese e kalimeve horizontale të lidhjeve të brendshme nga kollonat tek pusetat primare.

6.5.2. Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit inxhinierik nëntokesor të shkarkimit të ujrave të shiut.

6.5.3. Rikonstruksioni i rrrjetit të shkarkimeve të ujrave të shiut parashikuar në fazën para projekt idese.

6.6. IMPIANTI I MBROJTJES KUNDRA ZJARRIT

6. PROJEKTET MEKANIKE të RIKONSTRUKSIONI

6.1. Hyrje.

Zona e marre në studim e quajtur ansambli ndërtimor në qytetin e Vlorës, është një nga qendrat e qytetit e pozicionuar në pjesën veri-lindore të Sheshit të Flamurit. Objektivi kryesor në këtë projekt rikualifikimi urban, përfshijne ndërhyrjet e nevojshme në të gjitha disiplinat inxhinierike duke identifikuar gjuhën arkitektonike karakteristike të zonës dhe me fokus mostjetërsimin e trashëgimisë kulturore. Kështu në përshtatje me ndërhyrjet arkitektonike janë realizuar ndërhyrje edhe në rrjetet inxhinierike duke e bërë funksionale dhe njëkohesisht duke ruajtur statusin monument kulture.

Rrjetet inxhinierike që do të rikonstruktohen janë:

- Impianti i furnizimit me ujë sanitar,
- Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza,
- Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut,
- Impianti i mbrojtjes kundër zjarrit (do të ndërtohet i ri)

6.2. VËSHTRIM EKONOMIKO SOCIAL DHE GJENDJA TEKNIKE E RRJETIT INXHINIERIK TË ZONËS NË STUDIM.

Objekt i këtij projekti është rikualifikimi urban për zonën në studim që përfshin rrugët: Ceno Sharra, Irfan Shehu, Justin Godard si dhe godinat gjatë këtyre rrugëve.


Ky ansambel përfaqëson ndërtime të hershme që nga shekulli i XIX dhe ka patur një karakter tregetar – administrativ si dhe qendra kryesore e banimit. Godinat me fasada në rrugë, katet e para të tyre kanë shërbyer si dyqanë apo për aktivitete të ndryshme jetësore social - kulturore etj, ndërsa katet e sipërme kanë shërbyer për banim. Gjithashtu godinat më në brendësi të zonave kanë shërbyer kryesisht për banim.

Nga pikpamja e veshtrimit ekonomik social, godinat të cilat shtrihen përgjatë rrugës Perlat Rexhepi zhvillojnë ende një aktivitet ekonomik social të qëndrueshem, ndërsa godinat që shtrihen në thellësi të zonave si në rrugët Justin Godard, Irfan Shehu, Ceno Sharra, kanë pësuar një degradim të thellë ekonomik –social duke e humbur karakterin e tyre dhe duke çënuar vlerat historike-kulturore.

Ky fenomen i degradimit ekonomik-social të këtyre zonave është mjaft i rëndësishëm jo vetëm në pikepamje të vlerave dhe të memories arkitektonike apo historiko – kulturore, por ka sjelle si pasojë mosvëmendjen në drejtim të mirëmbajtjes, riparimeve, ndërhyrjeve dhe përmiresimeve apo rikonstruktionëve të nevojshme për infrastrukturen inxhinierike në përgjithësi. Kjo infrastrukture ashtu sikurse degradimi ekonomik –social paraqitet mjaft e degraduar.

Konstatohen godina të rrënuara, godina të braktisura, godina të shfrytëzueshme deri në kufijte e pamundësisë, instalimet inxhinierike të cilave janë tejte të amortizuara apo edhe inekzistente, godina të rikonstruktura me zgjidhje jo profesionale si dhe rrugë të vjetra të degraduara në të

cilën nuk mund të identifikohen rrjetet inxhnierike sipas funksioneve, për më tepër që një pjesë e tyre janë problematike për zhvillimin normal të jetës social ekonomike etj.



Po të kemi parasysh që zona në studim qëndron si një “ishull” në mes të qytetit të Vlorës, nuk është e mundur që nëpërmjet këtyre projekteve të kuptohet funksionaliteti i rrjetit inxhinierik si dhe marrëdhëniet që kanë instalimet e kësaj zone me gjithë rrjetin inxhinierik të qytetit, me të cilën këto rrjete bashkëveprojnë për shkak të vijueshmerise së funksionit të tyre.

Nga sa sqaruam më sipër për veshtiresitë e hasura në hartimin e këtij relacioni teknik, për zgjidhjen e mjaft probleme teknike jemi mbështetur në konsultimin teknik të specialisteve të Drejtorise së UKV.

Me poshtë do të sqarojmë mënyrën e konceptimit të realizimit të rikonstruksionit të rrjeteve inxhinierike në përputhje maksimalisht të mundshme me kerkesat e ToR dhe nevojat praktike të zgjidhjes së problemeve reale të rrjeteve inxhinierike të kësaj zone të qytetit të Vlorës.

6.3. KRITERET E RIKONSTRUKSIONIT TË IMPIANTI I FURNIZIMIT ME UJE SANITAR

Impianti i furnizimit me uje sanitar është rikonstruktuar mbi bazë të kriterëve të mëposhtme:

- *Analiza e gjëndjes ekzistuese të rrjetit të furnizimit me ujë:* kjo analize na ka shërbyer për të kuptuar gjëndjen ekzistuese dhe problemet që duhet të zgjidhen nëpërmjet rikonstruksionit të impiantit të furnizimit me ujë.
- *Rikonstruksioni i rrjetit ujesjelles parashikon:* Ky rikonstruksion konsiston në zëvendësimin e linjave të vjetra të cilat janë të amortizuara dhe shkaktojnë humbje në rrjet si dhe ndotjen e ujit. Gjithashtu është parashikuar rikonstruksioni i lidhjeve kryesore i magjistraleve me degezimet sekondare duke rikonstruktuar pusetat përkatese dhe armaturat lidhese si saracinëska, valvola moskthimi, reduktor presioni etj. Me tej ky rikonstruksion do të shtrihet deri në realizimin e lidhjeve të konsumatoreve me linjat e rikonstruktura, duke garantuar lidhje eficiente si dhe duke kompletuar elementet e nëvojshëm të administrimit të konsumit të ujit si saracineska ndërprerëse, kontatorët matës etj nën administrimin e ndërmarrjes UKV.


6.3.1. Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit të furnizimit me uje.

Gjendja e ekzistuese e zonës së marrë në studim si e përmendem edhe më sipër paraqitet e degraduar jo vetëm në pikepamjen funksionale të godinave por edhe në rrjetet inxhinierike në shërbim të tyre. Kështu duke kryer vërtetime në vend dhe duke analizuar materialet e vëna në dispozicion nga autoritetet përkatese, konstatohet se: në rrugën Perlat Rexhepi në dy anët e saj shtrihen dy linja të furnizimit me ujë sanitar. Njëra linjë është me dimension Ø400 material PEHD. Nga kjo linjë degezohet edhe një linjë Ø 200 që furnizon rruget Teli Ndini, por kjo linjë me dimension Ø 200 që përshkon rrugën Irfan Shehu është e lidhur njëkohsisht me linjën me dimension Ø 400 që shtrihet në rrugën Ismail Qemali me një degëzim pranë sheshit të Flamurit.

Linja tjetër që shtrihet në rrugën Perlat Rexhepi është një linjë me dimension Ø 150 material gize e cila kryqëzohet me një linjë që shtrihet në rrugën Ismail Qemali, përshkon rrugën Perlat Rexhepi dhe vazhdon në rrugën Ali Demi.

Në njërin prej projekteve të vjetra shohim që në rrugën Justin Godard shtrihet një linjë me dimension $\varnothing 150$ material gize i cili nuk reflektohet në projektin e viti 2010.





6.3.2. Rikonstruksioni i rrjetit të ujsjellesit.

Rikonstruksioni i rrjetit të ujesjellesit në këtë faze të projektit është përqëndruar në drejtimet kryesore si me poshte:

- a. Në rikonstrukcionin e linjave të vjetra të cilat janë të amortizuara dhe shkaktojnë humbje në rrjet si dhe ndotjen e ujit, duke i zëvendësuar të gjitha linjat me material gize me linja të reja me material PEHD. Për këtë arsye do të zëvendësohen linja Ø 150 në rrugën Perlat Rexhepi, linja Ø 150 në rrugën Irfan Shehu dhe linjën Ø 150 në rrugën Justin Godard.
- b. Në rikonstrukcionin e linjave që shtrihen në brëndesi të blloqeve të banësave nëpërmjet degëzimeve sekondare me dimensionë me të vogla mbi bazë të kapaciteteve furnizuese të konsumatoreve. Në secilin prej ketyre degezimeve është parashikuar vendosja e pushtave në të cilën do të vendosen armaturat hidraulike si saracineska, reduktore presioni, ajernxjerres etj.
- c. Në degezimet sekondare do të bëhen të gjitha lidhjet me konsumatorët fundorë si banësa, objekte social – kulturore - historike etj të cilat do ti nënshtrohen rikonstrukcionit arkitektonik që do të jenë objekt i këtij projekti.

- d. Të gjithë konsumatorët e furnizuar nëpërmjet lidhjeve të reja janë plotësuar me grupin e ri të furnizimit me uje (saracinëske ndërprerëse me vulë nga UKV, kontator matës konsumi, reduktor presioni, valvol moskthimi si dhe ajërnxjerres), të vendosur në kasetë në muret e jashtme të godinave me qëllim administrimi nga personeli i UKV.



Per kete zgjidhje kemi rene dakort ne konsultat e zhvilluara me Koordinatorin e ADF, Specialist te Ujsjelles-Kanalizimeve te Bashkise Vlore, Perfagesuese se Firmes Kontraktore te projektit IPA 2012.

6.4. KRITERET E RIKONSTRUKSIONIT TË IMPIANTIT TË SHKARKIMIT TË UJRAVE TË ZEZA

Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza është parashikuar të rikonstruktohet mbi baze të kritereve të mëposhtme:

- *Analiza e gjendjes ekzistuese e kalimeve horizontale të lidhjeve të brendshme nga godinat tek pusetat primare* : kjo analize shërben për të kuptuar situatën reale.
- *Analiza e gjendjes ekzistuese të kolektoreve të rrjetit inxhinierik nëntokesor të shkarkimit të ujrave të zeza*: kjo analizë shërben për të kuptuar gjendjen ekzistuese dhe problemet që duhet të zgjidhen nëpërmjet rikonstruksionit të impiantit të shkarkimit të ujrave të zeza.
- *Rikonstruksioni i rrjetit të shkarkimeve të ujrave të zeza*: Ky rikonstruksion do të konsistoje në zëvendësimin e linjave të vjetra të cilat janë të amortizuara që shkaktojnë dhe ndotjen e ambientit përreth si dhe linjat që kërkojnë rritje kapaciteti shkarkues. Ndarjen dhe rikonstruksionin e linjave të shkarkimit të ujrave të zeza, të vecanta nga linjat e shkarkimit të ujrave të shiut. Gjithashtu do të rikonstruktohen lidhjet kryesore të rrjeteve sekondare me kolektoret duke rikonstruktuar pusetat përkatëse. Me tej ky rikonstruksion do të shtrihet deri në realizimin e lidhjeve të shkarkimeve të godinave me rrjetet sekondare apo/dhe me kolektoret e rikonstruktuar, duke garantuar lidhje eficiente si dhe duke kompletuar elementet e nevojshëm të administrimit të shkarkimit si pika lidhëse ose inspektimi nën administrimin e ndërmarrjes UKV.

6.4.1. Analiza e gjendjes ekzistuese e kalimeve horizontale të lidhjeve të brendshme nga godinat tek pusetat primare

Gjendja e ekzistuese e lidhjeve të brendshme deri tek pusetat primare të zonës së marrë në studim sic e përmendëm edhe me sipër paraqitet e degraduar jo vetëm në pikëpamjen funksionale të godinave por edhe në rrjetet nxhinierike në shërbim të tyre.

Nga investigimet në vend konstatohen godina të rrenuara apo të braktisura, në të cilat tubacionët lidhese me magjistralin kryesor janë tejet të amortizuara apo edhe inekzistente, duke shkaktuar shkeputje të rrjetit e duke u bërë edhe burim ndotje të zonës përreth.

Për sa i takon ketyre lidhjeve për cdo godinë ne nuk kemi informacion se si ato mbliidhen dhe shkarkojnë në magjistralin kryesor.



6.4.2. Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit inxhinierik nëntokesor të shkarkimit të ujrave të zeza:

Nga vrojtime në vend dhe duke analizuar materialet e vena në dispozicion nga autoritetet përkatëse (projekti i vitit 2010), konstatojmë se: në rrugën Perlat Rexhepi, në aksin e saj shtrihet rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza me dimension $\varnothing 400$, ndersa magjistrali që shtrihet përgjate rruges Ceno Sharra shkarkon në magjistralin kryesor të rruges Perlat Rexhepi. Vëme re se pusetat janë në një distancë afersisht 50 m larg njera tjetres.

Rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza në fillim të rruges Irfan Shehu mbasi mbledh edhe ujrën e zeza që shkarkojnë përgjate rruges Dalan Dadani, vazhdojnë përgjate rruges Irfan Shehu. Kjo vëhet re edhe në projektet e vena në dispozicion të projektit IPA 2012.

Pas kërkesës sone të vazhduar për të marrë informacione për rrjetet inxhinierike në rrugën Justin Godard, nga organet përkatëse kemi marrë një projekt në të cilin tregohet në këtë rrugë shtrihet një kolektori i vjetër i ndërtuar me tulle me harqe që njihet si rrjeti me emrin “qemer”.

Në këtë rrugë edhe pse janë kryer punime rikonstruksioni për rrjetin vitet e fundit rezulton se janë bashkuar rrjeti i ujrave të zeza me rrjetin e ujrave të bardha ne kolektorin e njohur si “qemeri” qe shkarkon ne drejtim te sheshit te Flamurit.



6.4.3. Rikonstruksioni i rrjetit të shkarkimeve të ujrave të zeza të parashikuar

Rikonstruksioni i rrjetit të shkarkimit të ujrave të zeza në këtë faze të projektit është përqëndruar në drejtimet kryesore si me poshte:

- a. Në rikonstruksionin e linjave të vjetra nga godinat deri në pusetat primare, të cilat janë të amortizuara dhe shkaktojnë bllokime të rrjetit si dhe ndotjen e territorit përreth duke shkaktuar aroma të pakëndshme, duke i zëvendësuar të gjitha linjat e amortizuara me linja të reja me material PEHD.
- b. Në rikonstruksionin e linjave primare që shtrihen në brendësi të blloqëve të banësive deri në rrjetet mbledhëse sekondare, mbi baze të kapaciteteve shkarkuese të konsumatoreve të cilat do të nënshtrohen rikonstruksionit arkitektonik që do të jenë objekt i këtij projekti. Është parashikuar vendosja apo rikonstruksioni i pusetave si dhe do të plotësohen puseta kontrolli e inspektimi.
- c. Është parashikuar rikonstruksioni i rrjetit të përzier me emrin “qemer” (i ujrave të zeza dhe të shiut) në rrjete të vecanta për shkarkimin e ujrave të zeza vec dhe të shiut.

Ujrat e zeza që shtrihen në rrugën Irfan Shehu mbasi bashkohen edhe me ujrat e rrugës Dalan Dadani nuk kalojnë në rrugën Justin Godard por vazhdojnë përgjatë rrugës Irfan Shehu. Mëqenëse rruga Justin Godard rezulton në kuotë me të ulët se rrugët në të cilat rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza është rikonstruktuar, magjistralin kryesor të shkarkimeve të rrugës Justin Godard nuk mund ta bashkojmë me asnjë prej këtyre rrjeteve. Rruga Justin Godard do të trajtohet me vehte, rrjeti i saj do të jetë i shkeputur nga rrjeti i shkarkimeve të ujrave të rrugëve kufizuese dhe do të vazhdojë drejtimin e paracaktuar për mirefunksionimin e tij drejt Sheshit të

Flamurit paralel me kolektorin me ‘qemer’. Kështu do të realizojmë një rrjet të ri të shkarkimit të ujrave të zeza të ndare nga rrjeti i ujrave të bardha, funksional me të gjitha parametrat teknike të nevojshëm sipas normave teknike vetëm për pjesën e rrugës Justin Godard, e cila në përputhje me ToR është pjesë e këtij projekti zbatimi.

Për të bërë të mundur realizimin të rikonstruksionit, është paraqitur grafikisht plani i përgjithshëm i ndërhyrjes për të përballuar nevojat reale të shkarkimit të ujrave të zeza për këtë pjesë të rrugës, në përputhje me zgjidhjet arkitektonike dhe të mobilimit urban të kësaj zone.

Theksojmë se në projektin e paraqitur sic e shpjeguam edhe më sipër kemi ndjekur gjurmën e kolektorit ekzistues me “qemer”, duke ndërtuar një kolektor të ri sipas kësaj gjurme, paralel me të duke ruajtur mosprekjen e qemerit i cili do të rikonstruktohet me vete. Propozojmë që të gjithë traseja e kolektorit me qemer të rikonstruktohet edhe përtej zonës në studim përgjatë sheshit të Flamurit, deri në një lidhje provizore me rrjetin ekzistues të qytetit, mbasi koncepti i rikonstruksionit të rrjeteve inxhinierike në rrugën Justin Godard presupozon ndarjen e rrjeteve të ujrave të zeza nga rrjeti i ujrave të bardha dhe për këtë arsye sygjerojmë që ky koncept të mbahet edhe përtej kësaj rruge. Ndarja e dy rrjeteve është arsyeja teknike për rikonstruksionin e rrjeteve të kësaj rruge por gjithashtu nënvijëzojmë se pjesë të kolektorit të vjetër me qemer në zonën e sheshit të Flamurit janë të demtura dhe jashtë funksionit, kështu që ndërhyrja është e domosdoshme edhe për këtë arsye.

Per këtë zgjidhje kemi rënë dakort në konsultat e zhvilluara me Koordinatorin e ADF, Specialist të Ujshjellës-Kanalizimeve të Bashkisë Vlorë, Përfaqësues të Firmës Kontraktore të projektit IPA 2012.

6.5. KRITERET E RIKONSTRUKSIONIT TË IMPIANTIT TË SHKARKIMIT TË UJRAVE TË SHIUT

Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut është parashikuar të rikonstruktohet mbi baze të kriterëve të mëposhtme:

- *Analiza e gjendjes ekzistuese e kalimeve horizontale të lidhjeve nga ulluket e çative apo varangat e tarracave nëpërmjet kollonave deri tek pusetat primare*: kjo analizë ka shërbyer për të kuptuar situatën ekzistuese.
- *Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit inxhinierik nëntokesor të shkarkimit të ujrave të shiut*: kjo analizë shërben për të kuptuar gjendjen ekzistuese dhe problemet që duhet të zgjidhen nëpërmjet rikonstruksionit të impiantit të shkarkimit të ujrave të shiut. Në këtë analizë do të studiohen si shkarkimet nga godinat ashtu edhe nga ujrën sipërfaqësore në rrugë, në trotuare e në sheshe.
- *Rikonstruksioni i rrjetit të shkarkimit të ujrave të shiut është parashikuar*: Ky rikonstruksion konsiston në zëvendësimin e linjave të vjetra të cilat janë të amortizuara që shkaktojnë bllokim të rrjetit apo krijojnë kushte për formimin e lageshtisë në fasada apo me pellgje uji në rrugë e trotuare apo ndërtimin e rrjeteve të reja aty ku këto rrjete mungojnë. Në këtë kontekst do të ketë një përqasje ndërmjet zgjidhjeve arkitektonike të godinave, rrugëve, truareve, shesheve apo edhe elementeve ujore si shatërvanë etj, me zgjidhjet teknike të shkarkimit të ujrave të bardha. Gjithashtu do të rikonstruktohen

lidhjet kryesore magjistrale me degëzimet sekondare duke rikonstruktuar pusetat përkatëse.

6.5.1. Analiza e gjendjes ekzistuese e kalimeve horizontale të lidhjeve të brendshme nga kollonat tek pusetat primare

Gjendja ekzistuese e lidhjeve të brendshme nga catite apo tarracat nëpërmjet kollonave të shkarkimit deri tek pusetat primare të zonës së marre në studim sic e përmendëm edhe me sipër paraqitet e degraduar jo vetëm në pikepamjen funksionale të godinave por edhe në rrjetet inxhinierike në shërbim të tyre.

Nga investigimet në vend konstatohen godina të rrenuara apo të braktisura, në të cilat kollonat e shkarkimit të ujrave të cative apo tarracave nuk ekzistojnë, janë të shkeputura dhe uji rrjedh në fasada duke i demtuar ato dhe strukturat ndërtimore etj, ose kollona që rrjedhin lirshëm në trotuare. Gjithashtu vihen re se tubacionët lidhës nga godina në pusetat primare në rrjetin primar të cilat janë tejet të amortizuara apo edhe inekzistent.



6.5.2. Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit inxhinierik nëntokesor të shkarkimit të ujrave të shiut:

Duke kryer vërtetime në vend dhe duke analizuar materialet e vëna në dispozicion nga autoritetet përkatëse (projekti i vitit 2010), konstatohet se : në rrugën Perlat Rexhepi , në të dy anët e saj shtrihen dy rrjete të shkarkimit të ujrave të shiut.

Ujrat e shiut që mbledhen nga catite e godinave që shtrihen përgjatë rrugës Perlat Rexhepi, do të shkarkojnë në rrjetin ekzistues të kësaj rruge.

Ujrat e shiut sipërfaqësorë dhe ato të godinave që shtrihen përgjatë rrugës Irfan Shehu mbledhen në kolektorin kryesor dhe vazhdojnë përgjatë kësaj rruge.

Nga investigimet në vend dhe konsultat me specialistet përkates dihet se rrjeti i ujrave të shiut në rrugën Justin Godard bashkohet me ujrat e zeza të po kesaj rruge , ne kolektorin e vjeter te njohur “ qemer” .



Nga të gjitha projektet ,te reja dhe të vjetra mungojnë rrjetet degezimet në brendesi të blloqëve të banësave si dhe të gjitha shkarkimet nga tarracat, catite dhe trotuaret.

6.5.3. Rikonstruksioni i rrjetit të shkarkimeve të ujrave të shiut te parashikuar

Rikonstruksioni i rrjetit të shkarkimit të ujrave të shiut në këtë faze të projektit është përqëndruar në drejtimet kryesore si me poshte:

- a. Rikonstrukcioni i ullukeve të cative dhe varangave të tarracave, ndertimi i kollonave të shkarkimit të ujrave të tyre në përputhje me kerkesat arkitektonike duke mbajtur karakteristike historike të trasheguara.
- b. Në rikonstrukcionin e linjave të vjetra të shkarkimit nga kollonat e cative e tarracave të godinave në përputhje me rikonstrukcionin arkitektonik si të godinave edhe të rrugëve e shesheve që do të krijohen, deri në pusetat primare, të cilat janë të amortizuara duke shkaktuar bllokime të rrjetit, prishjen e fasadave duke krijuar lageshti edhe në strukturat e brendshme të godinave, duke i zevendesuar të gjitha linjat e amortizuara me linja të reja me material PEHD.

- c. Rikonstruksioni i linjave primare që do të shtrihet në brendësi të blloqëve të banësave deri në rrjetet mbledhese sekondare, mbi baze të kapaciteteve shkarkuese të rrugeve e trotuareve të cilat do të nënshtrohen rikonstruksionit arkitektonik që do të jenë objekt i këtij projekti. Do të parashikohen vendosja apo rikonstruksioni i pusetave si dhe do të plotesohen puseta kontrolli e inspektimi.
- d. Do të rikonstruktohet rrjeti i përzier prej “qemer” (i ujrave të zeza dhe të shiut) në rrjete të vecanta për shkarkimin e ujrave të zeza vec dhe të shiut. Qemeri i rikonstruktuar do të shfrytëzohet vetëm për ujrat e bardha , mbasi ujrat e zeza janë në rrjet me vete.

Meqenëse rruga Justin Godard rezulton në kuotë më të ulët se rruget kufizuese, për të bërë parandalim të ujrave të shiut që mund të vijnë nga rruga Irfan Shehu, në krye të kësaj rruge kemi parashikuar kuletat mbledhese të cilat shkarkojnë në qemerin e rruges Irfan Shehu. Rruga Justin Godard do të trajtohet më vehte, rrjeti i saj do të jetë i shkeputur nga rrjeti i shkarkimeve të ujrave të rrugeve kufizuese.

Për mbledhjen e ujrave sipërfaqësore dhe nga çatitë e godinave të rruges Justin Godard kemi parashikuar dy rrjete, në të dy anët e rruges (sipas pjerresive të rruges) dhe do të vazhdojë drejtimin e paracaktuar për mirëfunksionimin e tij duke shkarkuar në qemer në fund të rruges Justin Godard.

Theksojmë se në projektin e paraqitur siç e shpjeguam edhe më sipër kemi ndjekur drejtimin e shkarkimit të kolektorit ekzistues prej “qemeri”, duke ndërtuar dy rrjete të reja, sipas këtij drejtimi shkarkimi , në të dy anët e rrugeve.

Kështu do të realizojmë një rrjet të ri të shkarkimit të ujrave të bardha, e ndarë nga rrjeti i ujrave të zeza , funksional më të gjitha parametrat teknike të nevojshëm sipas normave teknike vetëm për pjesën e rruges Justin Godard , e cila në përputhje me ToR është pjesë e këtij projekti zbatimi

Për këtë zgjidhje kemi rënë dakort në konsultat e zhvilluara me Koordinatorin e ADF, Specialist të Ujsjelles-Kanalizimeve të Bashkisë Vlorë, Përfaqesues të Firmës Kontraktore të projektit IPA 2012.

6.6. IMPIANTI I MBROJTJES KUNDRA ZJARIT

Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit është implant që nuk ka ekzistuar në këtë zonë dhe për këtë arsye ai do të ndërtohet i ri. Ky implant konceptohet si imipant i mbrojtjes se jashtme që do të thote do të shtrihet përgjate rrugeve dhe do të shërbejë për shuarjen e zjarreve të godinave nga jashte tyre ose do të sherbeje për furnizimin e autozjarrefikeseve të brigatës së zjarrefikeseve të qytetit. Impianti i mbrojtjes nga zjarri do të lidhet me rrjetin e jashtem ujesjelles në degezimet me dimensionë jo me të vogel se DN 65 ose në kolektoret me dimensionë me të medha sipas pozicionëve në përputhje me keto segmente tte rrjetit të jashtem. Vetekuptohet që rrjeti duhet të garantoje disa parametra sic është furnizimi me uje 24 ore, prurja e nëvojshme si dhe presioni.

Në kushtet në të cilat furnizimi me ujë i qytetit nuk sigurohet për 24 ore, atëhere edhe efektiviteti i ketij implanti do të jete në vartesi të ketij regjimi furnizimi, ndersa për prurjen dhe presionin do të behen llogaritjet e nëvojshme teknike.

Hidrantet parashikohen të jenë të tipit nëntoke në varësi të pozicionëve të tyre përkundrejt parametrave të rruges apo trotuareve si dhe në vartesi të pozicionëve me godinat.

Distanca ndermjet tyre parashikohet jo me shume se 100 m, në përputhje me normat përkatese.

